



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

DREJTORIA TEKNIKE

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)**

Data 02.09.2024

Nr. ____prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2024

OPERATORIT EKONOMIK “EURO MEGA 2010” SHPK

Adresa: Tiranë, Rruga e Kavajes, Ndërtim një katësh Nr.2, pranë Ambasades Turke

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar** (marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues).

Numri i procedurës/referenca e Lotit: me numër reference Loti 1: **REF 12064-07-03-2024**
Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Loti I. "Blerje Detergjent për Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", me fond limit të Marrëveshjes Kuadër: 19,092,667 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH për nevoja të Autoritetit Kontraktore përfituese Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza".**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Deri në 24 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër. Lëvrimi/dorëzimi i mallit për lotin e parë do të bëhet brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës/kontratave brenda marrëveshjes kuadër nga autoritetet kontraktore përfituese.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.35 datë 08.07.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

1. Operatori ekonomik “ANBIM” sh.p.k

NUIS L81618008J

Vlera e ofertës pa tvsh = **12,902,000** (dymbëdhjetë milion e nëntëqind e dy mijë) **lekë pa TVSH**

2. Operatori ekonomik “ATLANTIK 03” sh.p.k

NUIS K22218003V

Vlera e ofertës pa tvsh = **16,420,000** (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e njëzet mijë) **lekë pa TVSH**

3. Operatori ekonomik “BESIM KAMBERI” P.F

NUIS L42103023G

Vlera e ofertës pa tvsh = **16,243,000** (gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e dyzet e tre mijë) **lekë pa TVSH**

4. Operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” sh.p.k

NUIS K91624505A

Vlera e ofertës pa tvsh = **15,272,000** (pesëmbëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë) **lekë pa TVSH**

5. Operatori ekonomik “FLORFARMA” sh.p.k

NUIS K21405001N

Vlera e ofertës pa tvsh = **15,272,000** (pesëmbëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë) **lekë pa TVSH**

6. Operatori ekonomik “GET klin” sh.p.k

NUIS L82420502U

Vlera e ofertës pa tvsh = **16,615,000** (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë) **lekë pa TVSH**

7. Operatori ekonomik “I&V Company” sh.p.k

NUIS M01809026H

Vlera e ofertës pa tvsh = **15,151,515** (pesëmbëdhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e një mijë ë pesëqind e pesëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH**

8. Operatori ekonomik “MURATI D” sh.p.k

NUIS K42003004T

Vlera e ofertës pa tvsh = **13,171,000** (trembëdhjetë milion e njëqind e dhtatëdhjetë e një mijë) **lekë pa TVSH**

Vlera e ofertës pa tvsh = **16,000,000** (gjashtëmbëdhjetë milion) lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “ANBIM” sh.p.k me NUIS L81618008J, me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit si më poshtë :

- Formulari përmbledhës i Vetëdeklarimit nuk është hedhur sipas formatit të shtojcës 8 të DST , pasi rezulton se formulari i paraqitur nga ofertuesi në SPE nuk është i plotë pasi është hequr pjesa e fundit e formularit standart si më poshtë:

“Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

Heqja e një pjese të formularit bie ne kundërshtim me Pikën 4 (*Formularët e tenderit dhe Listat Çmimeve*) të gërmës B (*PËRGATITJA E OFERTAVE*) të Seksioni I te DST , ku thuhet qartë se: “Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar”

- Nuk plotëson pikën 1 të seksionit 2.3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit (Dëshmi për furnizimet e ngjashme) pasi vlera totale e faturave të dërguara në SPE (*vetëm per artikujt e ngjashëm me objektin e prokurimit*) nuk plotëson limitin prej 39% te Fondit limit.

Konkretisht nga verifikimi i Faturave të paraqitura ne SPE rezulton se:

-Fatura nr. 402/2023 rezulton e korigjuar totalisht (me vlerë negative) me faturën nr. 405/2023 dhe për pasojë nuk llogaritet si faturë.

-Fatura nr.374/2023 rezulton e korigjuar totalisht (me vlerë negative) me faturën nr. 40/2024 dhe për pasojë nuk llogaritet si faturë.

-Fatura nr 13/2022 rezulton e korigjuar totalisht (me vlerë negative) me faturat nr.30/2022 dhe faturën nr.15/2022 dhe për pasojë nuk llogaritet si faturë.

-Fatura me nr 120/2022 rezulton e korigjuar (me vlerë negative) me faturat nr.123/2022 dhe 127/2022 dhe nuk llogariten vlerat e korigjuara.

-Fatura nr.65/2022 rezulton e korigjuar totalisht (me vlerë negative) me faturën nr. 70/2022 dhe për pasojë nuk llogaritet si faturë.

2. Operatori ekonomik “ATLANTIK 03” sh.p.k, me NUIS K22218003V, me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe konkretisht:

- Nuk plotëson pikën 1 të Kapacitetit Teknik (Dëshmi për furnizimet e ngjashme) pasi vlera totale e faturave të dërguara në SPE (*vetëm per artikujt e ngjashëm me objektin e prokurimit*)nuk plotëson limitin prej 39% te Fondit limit.

3. Operatori ekonomik “FLORFARMA” sh.p.k, me NUIS K21405001N , me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe konkretisht:

- Nuk plotëson pikën 1 të Kapacitetit Teknik (Dëshmi për furnizimet e ngjashme) pasi vlera totale e faturave të dërguara në SPE (*vetëm per artikujt e ngjashëm me objektin e prokurimit*)nuk plotëson limitin prej 39% te Fondit limit.

4. Operatori ekonomik “I&V Company” sh.p.k, me NUIS M01809026H , me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe konkretisht:

- Nuk plotëson pikën 1 të Kapacitetit Teknik (Dëshmi për furnizimet e ngjashme) pasi vlera totale e faturave të dërguara në SPE (vetëm per artikujt e ngjashëm me objektin e prokurimit) nuk plotëson limitin prej 39% te Fondit limit.

5. Operatori ekonomik “MURATI D” sh.p.k, me NUIS K42003004T , me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe më konkretisht:

- Ne Formularin e Ofertës dhe konkretisht Shtojca 2 (Formulari i Sasisë dhe Grafiku i Lëvrimit), Operatori Ekonomik nuk ka ofertuar për artikullin nr.13 sipas shtojcës 6 të DST , gjë e cila e bën të pavlefshme ofertën e paraqitur.

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit:

1. EURO MEGA 2010 SH.P.K

K91624505A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar: 15,272,000 (*pesëmbëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë*) lekë pa TVSH.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR